

**MARRËVESHJE**

**MIDIS**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**DHE**

**ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE TË  
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS**

**PËR BASHKËPUNIMIN DHE ASISTENCËN E PËRBASHKËT  
ADMINISTRATIVE NË ÇËSHTJET DOGANORE**

## Ilyrie

**Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të Republikës së Shqipërisë**  
nga njëra anë;

dhe

**Administrata e Përgjithshme e Doganave të Republikës Popullore të Kinës,** nga ana tjetër;

Këtu e tutje të referuara si "Palët Kontraktuese";

**DUKE MARRË NË KONSIDERATË** rëndësinë e vlerësimit të saktë të detyrimeve doganore dhe të taksave të tjera, si dhe sigurimin e zbatimit të duhur të ndalimeve, kufizimeve dhe masave të kontrollit nga ana e administratave të tyre doganore;

**DUKE MARRË NË KONSIDERATË** se shkeljet e legjislacionit doganor dëmtojnë sigurinë e Palëve Kontraktuese dhe interesat e tyre ekonomike, tregtare, tatimore, shoqërore, kulturore dhe të shëndetit publik;

**DUKE NJOHUR** nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar në çështjet që lidhen me aplikimin dhe zbatimin e legjislacionit të tyre doganor;

**ME BINDJEN** se veprimet kundër shkeljeve doganore mund të bëhen më efektive nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet administratave të tyre doganore;

**DUKE PASUR PARASYSH** detyrimet e vendosura sipas konventave ndërkombëtare, tashmë të pranuar nga ose që zbatohen për Palët Kontraktuese;

**ME DËSHIRËN PËR** të nxitur dhe lehtësuar qarkullimin e mallrave dhe të udhëtarëve midis të dy vendeve nëpërmjet bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet administratave të tyre doganore dhe për të promovuar bashkëpunimin "Belt and Road";



Kanë rënë dakord si vijon:

## NENI PËRKUFIZIME

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

(a) "Administratë doganore" do të thotë, në Republikën e Shqipërisë: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe në Republikën Popullore të Kinës: Administrata e Përgjithshme e Doganave.

(b) "Legjislacion Doganor" do të thotë: dispozitat staturore dhe rregullatore të cilat lidhen me importimin, eksportimin, transbordimin, tranzitimin, ruajtjen dhe lëvizjen e mallrave, importimin dhe eksportimin e mallrave dhe mjeteve të transportit, administrimi dhe zbatimi i të cilave ngarkohen në mënyrë specifike te secila Administratë doganore, si dhe çdo rregullore e hartuar nga secila Administratë doganore ose nën autoritetin e saj statutor.

(c) "Shkelje doganore" do të thotë: çdo shkelje e Legjislacionit doganor.

(d) "Person" do të thotë: person fizik ose juridik.

(e) "Të dhëna personale" do të thotë: të gjitha të dhënat në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm.

(f) "Zyrtar" do të thotë: çdo zyrtar doganor ose agjent tjetër qeveritar i caktuar për të zbatuar legjislacionin doganor nga secila Administratë Doganore;

(g) "Administratë kërkuese" do të thotë: administrata doganore që kërkon asistencë.

(h) "Administratë e kërkuar" do të thotë: administrata doganore nga e cila kërkohet asistenca.

(i) "Informacion" do të thotë: çdo e dhënë, pavarësisht nëse është apo jo e përpunuar ose e analizuar, si dhe dokumente, raporte dhe komunikime të tjera në çdo format, duke përfshirë kopjet elektronike të autentifikuara ose kopjet e tyre të certifikuara apo të autentifikuara.

(j) "Territor Doganor" do të thotë: territori në të cilin zbatohet Legjislacioni Doganor i një Pale Kontraktuese.



## NENI 2 QËLLIMI I MARRËVESHJES

1. Palët Kontraktuese, nëpërmjet Administratave të tyre Doganore do t'i ofrojnë njëra-tjetrës asistencë administrative sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, për zbatimin e duhur të legjislacionit Doganor, për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.

2. E gjithë asistenca sipas kësaj Marrëveshjeje, do të ofrohet nga secila Palë Kontraktuese në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative të saj, brenda kufijve të kompetencës së administratës doganore dhe burimeve të disponueshme.

3. Asistenca, siç parashikohet në këtë Marrëveshje, nuk do të shtrihet në kërkesat për arrestimin ose ndalimin e personave apo në konfiskimin ose ndalimin e pronës ose në kompensimin e detyrimeve, taksave, gjobave apo çdo fondi tjetër në emër të Palës tjetër.

4. Kjo Marrëveshje ka për qëllim të përmirësojë dhe të plotësojë praktikat e ndërsjella aktualisht në fuqi të asistencës ndërmjet Palëve. Kjo Marrëveshje nuk do të pengojë bashkëpunimin e realizuar nga Palët Kontraktuese sipas marrëveshjeve apo aranzhimeve të tjera ndërkombëtare dhe asnjë dispozitë në këtë Marrëveshje nuk mund të interpretohet në një mënyrë që do të kufizonte marrëveshjet dhe praktikat në lidhje me asistencën dhe bashkëpunimin e ndërsjellë, të cilat tashmë janë në fuqi midis Palëve.

5. Kjo Marrëveshje synon vetëm asistencën administrative të ndërsjellë ndërmjet Administratave Doganore për çështje doganore. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të krijojnë nga ana e asnjë personi privat të drejtën për të marrë, fshehur ose përjashtuar asnjë provë ose për të penguar ekzekutimin e një kërkesë për asistencë.

6. Kjo Marrëveshje mbulon asistencën e ndërsjellë administrative midis Palëve Kontraktuese dhe nuk ka për qëllim të ndikojë në marrëveshjet e ndërsjellta të asistencës ligjore midis tyre. Nëse administrata doganore e Palës së kërkuar nuk është agjencia përkatëse, administrata e kërkuar do të tregojë cilat janë autoritete përkatëse.



### NENI 3 KOMUNIKIMI I INFORMACIONIT

1. Administratat Doganore do t'i paraqesin njëra-tjetrës, subjekt i ligjeve dhe rregulloreve vendase, qoftë me kërkesë ose me iniciativën e secilës, me informacion që ndihmon për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit doganor, parandalimin, hetimin dhe lufitën ndaj shkeljeve doganore. Ky informacion duhet të përfshijë:

(a) Informacionin që mund të ndihmojë në vlerësimin e saktë të detyrimeve doganore, të taksave të tjera të importit ose eksportit, të tarifave dhe detyrimeve dhe në veçanti, në përcaktimin e vlerës së mallrave për qëllime doganore dhe për klasifikimin tarifor;

(b) Informacionin që mund të ndihmojë në zbatimin e rregullit të origjinës;

(c) Informacionin që lidhet me shkeljet doganore të kryera në territorin doganor të administratës së kërkuar, në procesin e kryerjes ose në fazën e planifikimit.

2. Në rastet që mund të përfshijnë dëme të konsiderueshme për ekonominë, shëndetin publik, sigurinë publike ose interesa të tjera jetike të secilës Palë Kontraktuese, administrata doganore e Palës tjetër Kontraktuese, kurdo që të jetë e mundur, do të ofrojë asistencë me iniciativën e saj pa vonesë.

3. Administrata Doganore e njërës Palë, me iniciativën e saj ose me kërkesë, do t'i japë menjëherë administratës doganore të Palës tjetër të gjitha informacionet të cilat mund të jenë ndihmesë për këtë administratë doganore në lidhje me shkeljet, në veçanti, informacionin:

(a) që ka dalë në pah gjatë veprimtarive normale të administratës doganore të njërës Palë dhe që ka arsye të forta për të besuar se në territorin e Palës tjetër do të kryhet një shkelje e rëndë;

(b) që përfshin shkelje doganore në territorin e Palës tjetër, në lidhje me burimet e kontrabandës së mallrave, rrugët e trafikut të paligjshëm, si dhe mjetet dhe metodat e reja të kryerjes së veprimtarive të kontrabandës në lidhje me rastet e ekspozuara nga administrata doganore e njërës Palë;

(c) në lidhje me personat e njohur ose të dyshuar për kryerjen e shkeljeve ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e Palës tjetër; në



lidhje me mallrat e njohura si subjekt i trafikut të paligjshëm; në lidhje me mjetet e transportit të njohura ose që dyshohet se përdoren për kryerjen e shkeljeve ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e Palës tjetër;

(d) vëzhgimet dhe gjetjet që rezultojnë nga zbatimi i suksesshëm i mënyrave dhe teknikave të reja të zbatimit.

4. Informacioni i përmendur në paragrafet 1, 2 dhe 3 të këtij neni do të kërkohej vetëm në rastet kur është i nevojshëm për një çështje të veçantë. Në rastet kur administrata kërkuese ka dhënë sqarimin e domosdoshmërisë së informacionit të kërkuar për këtë çështje të veçantë, si dhe administrata e kërkuar e ka konfirmuar këtë domosdoshmëri, informacioni i dhënë nga administrata e kërkuar do të përfshijë dokumentacionin përkatës, raporte, prova të regjistruara ose kopje të autentifikuara të materialeve që tregojnë vlerën, natyrën dhe destinacionin e këtyre mallrave, si dhe legjislacionin doganor dhe procedurën e përdorur për heqimin e një shkeljeje doganore. Dokumentet e parashikuara në Marrëveshje mund të zëvendësohen me informacion elektronik të përgatitur në çfarëdo lloji forme për të njëjtin qëllim.

#### NENI 4 VERIFIKIMI

1. Me kërkesën e administratës doganore të njëjës Palë, administrata doganore e Palës tjetër do t'i komunikojë asaj administrate doganore informacionin në lidhje me çështjet e mëposhtme:

(a) autenticitetin e dokumenteve zyrtare të prodhuara në mbështetje të një Deklarate Mallrash të kryer në administratën doganore të Palës kërkuese;

(b) nëse mallrat e eksportuara nga territori i Palës kërkuese janë importuar në mënyrë të ligjshme në territorin e Palës së kërkuar;

dhe

(c) nëse mallrat e importuara në territorin e Palës kërkuese janë eksportuar në mënyrë të ligjshme nga territori i Palës së kërkuar.

2. Informacioni i përmendur në nënparagrafet b dhe c të paragrafit 1 të këtij neni, sipas kërkesës, përmban edhe procedurën doganore të përdorur për zhdoganimin e mallrave.



## NENI 5 HETIMI

Me kërkesën e Administratës Doganore të njërës Palë, Administrata Doganore e Palës tjetër, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, do të kryejë të gjitha hetimet ose verifikimet e nevojshme në lidhje me çështjet e përmendura në kërkesë, të cilat janë në qëllimin e Marrëveshjes, përfshirë marrjen në pyetje të personave të dyshuar për kryerjen e një shkeljeje, si dhe pyetjen e ekspertëve dhe të dëshmitarëve. Në rastet kur, sipas legjislacionit kombëtar, Administrata Doganore e Palës së kërkuar nuk është kompetente për të dhënë asistencën e përmendur në paragrafin I të këtij neni, brenda kufijve të kompetencës së saj, do të kërkojë të japë të gjithë asistencën e lidhur me kërkesën, siç mund të konsiderohet përshtatshme në aktivitetet e tij normale.

## ARTICLE 6 FORMA DHE PËRMBAJTJA E KËRKESAVE

1. Kërkesat për asistencë në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim dhe do të shoqërohen nga çdo informacion që konsiderohet i dobishëm me qëllim përmbushjen e këtyre kërkesave. Në rastet kur e kërkojnë rrethanat, kërkesat mund të bëhen gojarisht. Këto kërkesa duhet të konfirmohen me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Kërkesat për asistencë në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të përfshijnë të dhënat e mëposhtme:

- (a) emrin e administratës kërkuese;
- (b) çështjen në fjalë, llojin e asistencës së kërkuar dhe arsyet për kërkesën;
- (c) një përshkrim të shkurtër të çështjes në shqyrtim dhe dispozitat ligjore dhe administrative që zbatohen;
- (d) emrat dhe adresat e personave me të cilët ka lidhje kërkesa, nëse njihen;
- (e) kërkesat për metodat e komunikimit.

3. Të gjitha komunikimet ndërmjet Palëve në bazë të kësaj Marrëveshjeje, do të bëhen (në gjuhën zyrtare të Palës së kërkuar, ose) në



Anglisht ose në çdo gjuhë tjetër të pranuar zyrtarisht nga Pala e kërkuar.

4. Në rast se një kërkesë nuk arrin të plotësojë kërkesat e parashtruara në këtë nen, mund të kërkohet korrigjimi ose plotësimi i saj, por kjo nuk do të vonojë asnjë masë, e cila duhet të merret menjëherë.

## NENI 7

### ZBATIMI I KËRKESAVE

1. Administrata doganore e kërkuar do të marrë të gjitha masat e arsyeshme, brenda kompetencave dhe aftësive të saj, për të zbatuar kërkesën.

2. Administrata doganore e kërkuar do të veprojë në përputhje me kërkesën për të ndjekur një procedurë të caktuar, përveç rasteve kur kjo procedurë do të ishte në kundërshtim me ligjin e saj të brendshëm ose me praktikën normale në fuqi në vendin e Palës së kërkuar.

3. Origjinalet e dosjeve, dokumenteve dhe materialet e tjera do të kërkojnë vetëm në rastet kur kopjet nuk do të jenë të mjaftueshme dhe do të kthehen me mundësinë më të parë. Të drejtat e administratës së kërkuar ose të palëve të treta të lidhura me to, do të mbeten të paprekura.

4. Administrata doganore kërkuese, në qoftë se kërkon, do të këshillohet për kohën dhe vendin e veprimit që do të merret në përgjigje të kërkesës, në mënyrë që ky veprim të mund të koordinohet.

5. Në rast se kërkesa nuk mund të zbatohet, administrata kërkuese do të njoftohet menjëherë për këtë fakt, duke paraqitur arsyet dhe çdo informacion tjetër të cilin administrata e kërkuar e konsideron se mund të jetë ndihmë për administratën kërkuese.

## NENI 8

### PËRJASHTIMI NGA ASISTENCA

1. Në rastet kur çfarëdo asistencë e kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje mund të shkelë sovranitetin, sigurinë, politikën publike ose çfarëdo interes tjetër kombëtar të rëndësishëm të Palës Kontraktuese të kërkuar ose të paragjykojë çdo interes legjitim industrial, tregtar ose profesional, kjo asistencë mund të refuzohet nga ajo Palë Kontraktuese ose do të jetë në varësi të çdo afati apo kushtesh që ajo mund të kërkojë.



2. Asistenca mund të shtyhet nga administrata doganore e Palës së kërkuar për shkak se ajo do të ndërhyjë në një hetim, ndjekje penale apo procedim që është duke u zhvilluar. Në një rast të tillë administrata doganore e Palës së kërkuar do të konsultohet me administratën doganore të Palës kërkuese për të përcaktuar nëse asistenca mund të jepet duke iu nënshtruar afateve ose kushteve që mund të përcaktojë administrata doganore e Palës së kërkuar.

3. Në rastet kur administrata kërkuese nuk do të mund të bindet nëse një kërkesë e ngjashme është bërë nga administrata e kërkuar, ajo do të tërheqë vëmendjen ndaj këtij fakti në kërkesën e saj. Pajtueshmëria me një kërkesë të tillë do të jetë në diskrecionin e administratës së kërkuar.

4. Në rastet kur asistenca refuzohet ose shtyhet gjatë zbatimit të këtij neni, duhet të jepet menjëherë fakti dhe arsyet për refuzimin ose shtyrjen.

## NENI 9 PËRDORIMI, KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E INFORMACIONIT

1. Çdo informacion i marrë në këtë marrveshje do të përdoret vetëm nga Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese (duke iu nënshtruar kufizimeve të tilla që mund të përcaktohen nga pala që i jep ato) dhe vetëm për qëllime të ndihmës administrative sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje. Informacioni i tillë nuk duhet të përdoret si dëshmi në procedurat gjyqësore ose administrative, ose të transferohet në agjenci të tjera.

2. Autoriteti kërkuës nuk do t'i përdorë provat ose informacionin e marrë sipas kësaj Marrëveshjeje për qëllime të tjera nga ato të specifikuar në kërkesë, përpara se të merret miratimi me shkrim nga autoriteti i kërkuar.

3. Çdo informacion i marrë sipas kësaj Marrëveshjeje do të trajtohet si konfidencial dhe të paktën do të jetë subjekt i të njëjtit konfidencialitet dhe mbrojtje, ashtu siç është i njëjti lloj informacioni subjekt i dispozitave ligjore dhe administrative të Palës Kontraktuese ku është pranuar.

4. Në qoftë se sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të shkëmbehen të dhëna personale, Palët Kontraktuese do të mundësojnë një nivel mbrojtjeje



të këtyre të dhënave, i cili të plotësojë kërkesat e ligjit kombëtar të administratës doganore furnizuese.

#### **NENI 10 KOSTOT**

1. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, Administratat Doganore do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet për rimbursimin e shpenzimeve të bëra gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në qoftë se për zbatimin e kërkesës janë kërkuar ose do të kërkohen shpenzime të një natyre thelbësore dhe të jashtëzakonshme, administratat doganore të Palëve do të konsultohen për të përcaktuar afatet dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mënyrën me të cilën do të përballohen shpenzimet.

#### **NENI 11 ZBATIMI I MARRËVESHJES**

1. Palët do të identifikojnë pikat e kontaktit për qëllimet e trajtimit të çështjeve në lidhje me këtë Marrëveshje dhe të marrin masat e nevojshme për të siguruar, sa të jetë e mundur, që zyrtarët e tyre (të cilët janë përgjegjës për hetimin ose luftën ndaj shkeljeve doganore) të mbajnë marrëdhënie personale dhe të drejtpërdrejta me njëri-tjetrin.

2. Administratat doganore do të vendosin për aranzhmanet, për të lehtësuar zbatimin dhe aplikimin e kësaj Marrëveshjeje ndërmjet tyre.

3. Administratat Doganore të Palëve, në frymën e bashkëpunimit miqësor, do të zgjidhin, nëpërmjet konsultimit të plotë, çështjet që rrjedhin nga interpretimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

4. Mosmarrëveshjet për të cilat nuk gjenden zgjidhje, do të zgjidhen me mjete diplomatike.

5. Palët bien dakord që takimet ndërmjet përfaqësuesve të Administratave të tyre doganore mund të mbahen me kërkesën e secilës palë për rishikimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe çështjeve të interesit të ndërsjellë.



**NENI 12**  
**ZBATIMI TERRITORIAL I MARRËVESHJES**

Kjo Marrëveshje zbatohet në territorin doganor të Republikës Popullore të Kinës dhe në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

**NENI 13**  
**RISHIKIMI**

Palët kontraktuese do të takohen për të rishikuar Marrëveshjen me kërkesë ose në fund të pesë vjetëve nga data e hyrjes së saj në fuqi, përveç nëse ata njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim se nuk është i nevojshëm ky rishikim.

**NENI 14**  
**HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI**

1. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet shkëmbimit të notave diplomatike se janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë (90) pas datës të marrjes së njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje është lidhur për një kohëzgjatje të pakufizuar, por secila Palë, në çdo kohë, mund të kërkojë ndërprerjen e saj duke i dhënë Palës tjetër një njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Kjo Marrëveshje do të pushojë së qeni në fuqi në ditën e nëntëdhjetë (90) pas datës së marrjes së njoftimit të përfundimit nga Pala tjetër. Megjithatë, procedurat që janë duke u zhvilluar në kohën e ndërprerjes, duhet të përfundojnë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

**DUKE QENË TË PRANISHËM SA MË SIPËR**, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.



E LIDHUR në Budapest, më 27 nëntor 2017, në gjuhët shqipe, kineze dhe angleze, të tre tekstet janë njëllorj autentike. Në rast të ndonjë divergjence në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

Për Drejtorinë e  
Përgjithshme të Doganave të  
Republikës së Shqipërisë



Për Administratën e  
Përgjithshme të Doganave të  
Republikës Popullore të Kinës

